



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1001/prot.

Pogradec, më 26. 02. 2021

VENDIM

NR 39, DATË 26. 02. 2021

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL

Në mbështetje të, ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, pikës 2 të vendimit Nr. 108, datë 26.2.2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 144, datë 24.12.2020 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2021", i ndryshuar, Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 37, datë 25.02.2021 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Bashkisë Pogradec, Njësive Administrative dhe Institucioneve në varësi për vitin 2021", si dhe të raportit vjetor për pranimin në shërbimin civil për vitin 2021, nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,

VENDOSA :

1. Miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2021, sipas pozicioneve me kategoritë dhe grupet përkatëse të administrimit të përcaktuara në tabela si më poshtë:

Nr	Pozicioni i punës	Numri i vendeve vakante	Kategoria	Grupi i administrimit
1.	Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore	1	II-b	I përgjithshëm
2.	Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve	1	II-b	I posaçëm
3.	Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	1	II-b	I posaçëm
4.	Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Tokës dhe Koordinimit me Njësitë Administrative	1	II-b	I posaçëm
5.	Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë dhe Trajtimit të Titujve të Pronësisë	1	III-b	I posaçëm
6.	Specialist për koordinimin e integritetit evropian dhe ndihmës së huaj	1	IV-b	I përgjithshëm
7.	Specialist për llogaritje / rakordim për taksat dhe tarifatat vendore të biznesit	1	IV-a	I posaçëm

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

8.	Specialist për prokurimet publike dhe monitorimin e kontratave	1	IV-a	I posaçëm
9.	Specialiste për ankimet gjyqësore dhe administrative	1	IV-a	I posaçëm
10.	Specialist për të drejtën e informimit, bashkëqeverisjen dhe administrimin e kancelarive	1	IV-a	I përgjithshëm
11.	Specialist për teknologjinë e informacionit dhe komunikimin dixhital	1	IV-a	I posaçëm
12.	Specialist për projektet e infrastrukturës dhe planifikimin e territorit	1	IV-a	I posaçëm
13.	Specialist – Topograf	1	IV-a	I posaçëm
14.	Specialist për kontrollin e zbatimit të lejave/projekteve dhe dokumentacionit për certifikatë përdorimi	1	IV-a	I posaçëm
15.	Specialist për supervizim shërbimesh	1	IV-a	I posaçëm
Totali pozicione vakante për 2021		15		

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm janë, si më poshtë:

- Shkenca juridike,
- Shkenca ekonomike,
- Shkenca shoqërore,
- Shkenca sociale,
- Shkenca inxhinierike,
- Teknologji Informacioni
- Shkenca natyrore


3. Në respektim të pikës 4 të nenit 26 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, pozicionet si më poshtë të jenë të hapura edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të pozicioneve:

- 3.1 Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë, Muzeut dhe Trashëgimisë Kulturore
- 3.2 Drejtor i Drejtorisë së Çështjeve Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve
- 3.3 Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së Tokës dhe Koordinimit me Njësitë Administrative
- 3.4 Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë dhe Trajtimit të Titujve të Pronësisë

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorët e Drejtorive.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ilir XHAKOLLI



¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkia.pogradec@gmail.com